



# THIRRJA E DYTË për APLIKIME

3 qershor 2019

## 1. *Kujt i drejtohet?*

Kjo thirrje për aplikime u drejtohet artistëve dhe profesionistëve kulturorë (individë ose grupe deri në 5 persona) të moshës +18 vjeç dhe aktivë në fushat e arteve skenike dhe arteve vizuale, të të gjitha kualifikimeve arsimore dhe niveleve të përvojës, me banim të ligjshëm në një vend të "Evropa Krijuese".

Artet vizuale: *Artizanat – Dizajn – Arte dixhitale – Modë – Artet e bukura – Arte grafike – Fotografi*

Artet skenike: *Cirk – Kërcim – Opera – Shfaqje – Shfaqje teatri kukullash – Art i rrugës – Teatër*

Vendet e "Evropa Krijuese": *Shqipëria, Armenia, Austria, Belgjika, Bosnjë-Hercegovina, Bullgaria, Kroacia, Qipro, Republika Çeke, Danimarka, Estonia, Finlanda, Franca, Gjeorgjia, Gjermania, Greqia, Hungaria, Islanda, Irlanda, Italia, Kosova\*, Letonia, Lituania, Luksemburgu, Malta, Moldavia, Mali i Zi, Holanda, Maqedonia e Veriut, Norvegjia, Polonia, Portugalia, Rumania, Serbia, Sllovakia, Sllovenia, Spanja, Suedia, Tunizia, Ukraina dhe Mbretëria e Bashkuar.*

*\*Ky përcaktim nuk cenon qëndrimet mbi statusin dhe është në përputhje me RKSKB 1244/1999 dhe opinionin e GJND-së për shpalljen e pavarësisë së Kosovës.*

## 2. *Për çfarë?*

"i-Portunus" ofron mbështetje financiare për të ndihmuar në financimin e shpenzimeve të udhëtimit (transport, akomodim etj.) drejt një tjetër vendi të "Evropa Krijuese" (ose disave prej tyre).

- Kohëzgjatja e lëvizjes duhet të jetë nga 15 deri në 85 ditë dhe duhet të kryhet nga data 25 korrik deri në 31 dhjetor 2019.
- Lëvizja duhet të fokusohet te një projekt.
- Ai mund të jetë i vazhdueshëm ose me ndërprerje:
  - Lëvizja **e vazhdueshme** do të thotë se ju bëni një udhëtim vajtje-ardhje, drejt një ose më shumë destinacioneve.
  - Lëvizja **me ndërprerje** do të thotë se ju do të udhëtoni disa herë, drejt një ose më shumë destinacioneve. Çdo udhëtim duhet të zgjasë minimumi 5 ditë dhe numri total i ditëve duhet të jetë nga 15 deri në 85.

<i>Kalendari</i>	
Thirrja për aplikime:	3 qershor 2019
Afati i dorëzimit:	24 qershor 2019 (14:00, ora e Brukselit)
Shpallja e rezultateve:	16 korrik 2019
Data më e hershme e nisjes:	25 korrik 2019
Data e fundit e kthimit:	31 dhjetor 2019

Qëllimi kryesor i lëvizjes suaj duhet të jetë një nga sa vijon:

- ✓ **Bashkëpunimet** ndërkombëtare: Për shembull, jeni duke punuar me një partner ndërkombëtar për një vepër kulturore, si p.sh. një ekspozitë, shfaqje apo vepër teatrale.
- ✓ **Akomodimi** që lidhet me produksionin: Për shembull, rezultati i lëvizjes suaj do të jetë një prezantim publik të një sërë veprash të sapokrijuara - një ekspozitë, shfaqje, publikim etj.
- ✓ **Zhvillimi profesional:** Për shembull, do të merrni pjesë në audicione, takime ndërlidhjeje, ekspozita, seminare, klasa të avancuara (masterklasa) dhe lloje të tjera trajnimesh përtej arsimimit formal.
- ✓ **Prezantimi:** Për shembull, do të prezantoni një ekspozitë, jepni një shfaqje apo vini në skenë një vepër teatrale në vendin e destinacionit.

**Mbështetja financiare dhe buxheti i disponueshëm: çfarë shume?**

Shkalla e mbështetjes varet nga kohëzgjatja e lëvizjes:

15 deri në 29 ditë	1500 euro
30 deri në 59 ditë:	2400 euro
60 deri në 85 ditë:	3000 euro

Artistëve dhe profesionistëve kulturorë me aftësi të kufizuar mund t'u ofrohet mbështetje shtesë për lëvizjen.

### **3. Mënyra e aplikimit**

**Çfarë pritet nga ju**

Për të aplikuar duhet të organizoni një projekt me një institucion pritës ose partner në një vend tjetër (ose në disa vende të tjera) të "Evropa Krijuese". Në aplikimin tuaj, duhet:

- të përshkruani projektin dhe objektivin e tij kryesor,
- të shpjegoni mënyrën se si projekti i lëvizjes do t'ju mundësojë të arrini objektivin e përcaktuar,
- të paraqitni dokumente që tregojnë se keni bërë plane me një partner ose institucion pritës dhe se partneri/institucioni pritës është angazhuar në projektin tuaj.

Në aplikimin tuaj duhet të përshkruhet qartë mënyra se si kjo lëvizje do të ndikojë në zhvillimin tuaj profesional apo drejtimin e karrierës suaj (krijim, trajnim, bashkëpunime, karrierë apo perspektiva pune, ndërlidhje (networking) etj.).

**Kërkesat për pranim: informacioni që duhet paraqitur**

Për të aplikuar, duhet të krijoni një llogari dhe të plotësoni formularin e aplikimit në anglisht në: [my.i-portunus.eu](http://my.i-portunus.eu) përpara afatit të treguar në kutinë "Kalendari" (shih më sipër). Pas këtij afati (24 qershor 2019, ora 14:00 sipas orës së Brukselit) nuk do të mund ta ndryshoni aplikimin tuaj.

Do t'ju kërkohet të jepni llojet e mëposhtme të informacionit:

- Të dhëna personale
- Arsimimi
- Përvoja e punës
- Të dhënat e planifikimit të lëvizjes suaj (datat, destinacionet, mjeti i transportit)
- Informacion rreth projektit (përshkrimi, nevoja për lëvizje, përgatitja, ndikimi)
- Përshtypje për procesin e aplikimit

Si dhe dokumentet e mëposhtme (në format PDF):

- Një CV 1 faqe (maks. 10 MB)
- Një portofol (maks. 10 faqe, maks. 10 MB)
- Dokumente përkatëse që ndihmojnë në planin e lëvizjes, për shembull: letra ftese, konfirmime takimesh, marrëveshje bashkëproduksioni etj. (maks. 5 faqe, maks 10 MB)
- Një dëshmi e nënshkruar, nëpërmjet së cilës konfirmohet kualifikueshmëria juaj dhe deklarohet se kriteret e përjashtimit nuk ju cenojnë (shih pikën 7 më poshtë, maks. 10 MB).

#### **4. Kriteret e përzgjedhjes: si do të vlerësohet aplikimi juaj**

Të gjitha aplikimet do të vlerësohen në mënyrë të pavarur nga dy ekspertë: njëri i specializuar në vendin e origjinës dhe sektorin e aplikantit dhe tjetri i specializuar në vendin/vendet dhe sektorin e destinacionit.

*Ne do të punojmë me ekspertë të specializuar në rajone dhe sektorë të ndryshëm. Për qëllime paanësie, ne do t'i publikojmë emrat e tyre vetëm në përfundim të këtij projekti pilot.*

Vlerësuesit do të vlerësojnë aspektet e mëposhtme të aplikimit:

- **Rëndësia:** shkalla në të cilën lëvizja do t'ju ndihmojë në arritjen e rezultateve (20 pikë)
- **Përgatitja:** shkalla në të cilën është përgatitur projekti dhe lëvizja (20 pikë)
- **Rezultatet:** çfarë synoni të arrini si rezultat i lëvizjes (10 pikë)

Përzgjedhja përfundimtare e projekteve do të bazohet në pikët e fituara gjatë vlerësimit, por do të merren në konsideratë edhe shpërndarja gjeografike, përfshirja, çështjet gjinore, faktorët mjedisorë dhe natyra eksperimentale e projektit

Çdo vlerësues do të japë vlerësim për aplikimin tuaj dhe "pikët" përfundimtare do të jetë një mesatare e të dyja vlerësimeve.

Rezultatet e procesit të vlerësimit do t'ju bëhen të ditura me anë të emailit.

Aplikantët e përzgjedhur do të kontaktohen brenda 3-4 javëve nga afati i thirrjes. Të tjerët do të marrim një email që i njofton se nuk janë përzgjedhur. Për shkak të numrit të aplikimeve, ekipi i "i-Portunus" nuk do të japë arsytim mbi vendimin, i cili do të jetë i formës së prerë.

#### **5. Kriteret e kualifikueshmërisë: Cilat kanë kushtet?**

- Aplikimet duhet të paraqiten në anglisht, me anë të formularit të aplikimit në internet të "i-Portunus", deri në afatin e treguar në pikën 3 dhe në kalendarin më sipër.
- Aplikimet duhet të përmbajnë të gjithë informacionin e kërkuar në formularin e aplikimit, duke përfshirë dokumentet e bashkëngjitura, siç përmbliken në seksionin 3.
- Aplikantët duhet të jenë artistë ose profesionistë kulturorë (individë ose grupe deri në 5 persona) aktivë në fushat e arteve vizuale dhe skenike, minimalisht 18 vjeç dhe banorë të ligjshëm të një vendi të "Evropa Krijuese". Aplikantët dhe grupet e aplikantëve duhet të jenë individë, jo subjekte ligjore.
- Destinacioni i lëvizjes duhet të jetë një vend i "Evropa Krijuese".
- Data e nisjes duhet të jetë më 25 korrik 2019 ose më pas; data e kthimit duhet të jetë më 31 dhjetor 2019 ose më përpara. Kohëzgjatja totale e lëvizjes duhet të jetë nga 15 deri në 85 ditë (duke përfshirë ditët e udhëtimit) dhe mund të përfshijë një ose disa udhëtime. Lëvizja me ndërprerje do të llogaritet sipas numrit total të ditëve.
- Aplikanti nuk duhet të ketë marrë më parë mbështetje për lëvizjen nga "i-Portunus".

Mosrespektimi i këtyre kërkesave do të çojë në refuzimin e aplikimit tuaj.

## **6. Procedura: në rast se përzgjidheni**

### **Kontrata dhe pagesa fillestare si mbështetje për lëvizjen**

- Ju do të merrni një kontratë, të cilën duhet ta nënshkruani dhe ta ngarkoni në llogarinë tuaj "i-Portunus".
- Do t'ju kërkohet gjithashtu të jepni të dhënat e llogarisë bankare (me kodin BIC dhe IBAN).
- Pas marrjes së kontratës dhe të të dhënave bankare, 75% e mbështetjes për lëvizjen do të transferohet në llogarinë tuaj bankare.

Nëse aplikoni si grup: çdo anëtar i grupit do të nënshkruajë një kontratë individuale dhe do të marrë një pagesë individuale.

### **Raporti për aktivitetin dhe pagesa përfundimtare e mbështetjes për lëvizjen**

Duke qenë se "i-Portunus" është një projekt pilot lëvizjeje, do t'ju kërkohet të jepni përshtypje për programin përmes një raporti të thjeshtë mbi aktivitetin, brenda 2 javëve nga përfundimi i lëvizjes. Në këtë raport aktiviteti do të kërkohen informacionet e mëposhtme:

- Rezultatet: Si rezultat i lëvizjes, a u arritën pritshmëritë tuaja dhe si? Nëse jo, shpjegojeni (edhe nëse rezultati i tejkaloi pritshmëritë, edhe nëse nuk i arriti pritshmëritë tuaja).
- Bashkëlidhjet: Video, foto, dokumente që do të na japin një pasqyrë më të mirë të rezultateve të lëvizjes suaj. Nëse nuk kërkohet ndryshe, materialet vizuale do të përdoren në faqen e internet të "i-Portunus", duke përmendur emrin e artistit/profesionistit kulturor.
- Vërtetim për lëvizjen, p.sh.:
  - Karta elektronike e imbakimit / bileta e trenit
  - Fotografi të nënkontraktorit gjatë lëvizjes
  - Aktiviteti në media sociale

Pasi të keni plotësuar këtë raport në platformën e "i-Portunus", do të merrni 25% e mbetur të mbështetjes për lëvizjen. Nëse raporti për aktivitetin nuk dorëzohet brenda 6 javëve nga përfundimi i lëvizjes, 25% i mbetur nuk do të paguhet.



**E RËNDËSISHME!** Ju mbani përgjegjësi për të paguar gjitha taksat për mbështetjen që merrni për lëvizjen. Këtu mund të përfshihet tatimi i dyfishtë. Për detaje, shihni [https://europa.eu/youreurope/citizens/work/taxes/double-taxation/index\\_en.htm](https://europa.eu/youreurope/citizens/work/taxes/double-taxation/index_en.htm).

### **Përshtypje shtesë opsionale**

Duke qenë se "i-Portunus" është një projekt pilot, është e rëndësishme të marrim përshtypje, në mënyrë që të shfrytëzojmë përvojën tuaj për të përmirësuar skemën. Prandaj, pas lëvizjes do t'ju kërkohet të plotësoni një pyetësor që vlerëson skemën e lëvizjes.

## **7. Reklamimi**

### ***Nga ju***

Personat që marrin mbështetje financiare për lëvizjen duhet të njohin shprehimisht kontributin e Bashkimit Evropian në të gjitha publikimet ose në aktivitetet për të cilat është përdorur mbështetja financiare për lëvizjen.

Në këtë kuadër, personat që marrin mbështetje financiare për lëvizjen duhet të theksojnë emrin dhe logon e Bashkimit Evropian dhe të programit "Evropa Krijuese" në të gjitha publikimet e tyre, posterat, programet dhe produktet e tjera të realizuara nga projekti i bashkëfinancuar.

Për të bërë këtë, ata duhet të përdorin tekstin, logon dhe klauzolën e mohimit të përgjegjësisë në përputhje me detajet e dhëna në kontratën e përmendur në pikën 5 më sipër.

Nëse kjo kërkesë nuk respektohet plotësisht, mbështetja financiare që i jepet përfituesit për lëvizjen mund të reduktohet në përputhje me dispozitat e kontratës së sipërpërmendur.

Përveç tekstit dhe logos përkatëse të programit të BE-së, ekipi i "i-Portunus" do t'u japë përfituesve një klauzolë mohimi përgjegjësie – që do ta përdorin detyrimisht – në të cilën deklarohet se BE-ja nuk është përgjegjëse për pikëpamjet e shprehura në publikimet dhe/ose në aktivitetet për të cilat është përdorur mbështetja financiare për lëvizjen.

### ***Nga i"-Portunus"***

I gjithë informacioni në lidhje me mbështetjen financiare për lëvizjen që është dhënë në vazhden e një viti financiar do të publikohet në faqen e internetit të institucioneve të Bashkimit Evropian jo më vonë se data 30 qershor e vitit financiar në të cilin është ofruar mbështetja në fjalë.

"i-Portunus" do të publikojë informacionet e mëposhtme:

- emrin e përfituesit,
- lëndën e mbështetjes financiare për lëvizjen,
- shumën e dhënë.

Me anë të një kërkesë të arsyetuar dhe të argumentuar siç duhet nga përfituesi, publikimi nuk duhet të kryhet në rast se zbulimi i tij mund të vërë në rrezik të drejtat dhe liritë e individëve përkatës, të mbrojtura nga Karta e të Drejtave Themelore e Bashkimit Evropian, apo nëse mund të cenojnë interesat tregtare të përfituesve.

## **8. Kriteret e përjashtimit**

### ***Personeli i konsorciumit***

Anëtarët e personelit të organizatave të përfshira në përgatitjen e programit pilot të "i-Portunus" për vitin 2019 nuk kanë të drejtë për mbështetje:

- Personeli i programit "Evropa Krijuese"
- Personeli i "Goethe-Institut"
- Personeli i "Institut français" (Paris)
- Personeli i "Izolyatsia"
- "Nida Art Colony" e personelit të Akademisë së Arteve "Vilnius"

## **9. Dispozitat financiare**

### **Parimet e përgjithshme**

a) Fuqia jopravepruese

Dhënia e mbështetjes financiare për lëvizjen nuk ka fuqi prapavepruese për veprimet e përfunduara.

b) Kontratat e zbatimit/nënkontraktimi

Nëse për zbatimin e masës nevojitet dhënia e kontratave të prokurimit (kontratat e zbatimit), personi që merr mbështetje për financiar për lëvizjen duhet ta ruajë dokumentacionin në rast auditimi.

## **10. Mbrojtja e të dhënave**

Përgjigja ndaj çdo thirrjeje për aplikime përfshin regjistrimin dhe përpunimin e të dhënave personale (të tilla si emri, adresa dhe CV). Këto të dhëna do të përpunohen në përputhje me Rregulloren (BE) 2018/1725 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, të datës 23 tetor 2018, "Për mbrojtjen e personave fizikë në lidhje me përpunimin e të dhënave personale nga institucionet, organet, zyrat dhe agjencitë e Bashkimit Evropian, si dhe për lëvizjen e lirë të këtyre të dhënave": <https://eur-lex.europa.eu/legal-content/en/TXT/?uri=CELEX:32018R1725>

Përveç nëse specifikohet ndryshe, pyetjet dhe të gjitha të dhënat personale të kërkuara janë të nevojshme për të vlerësuar aplikimin në përputhje me specifikimet e thirrjes për aplikime dhe do të përpunohen vetëm për këtë qëllim nga ekipi i vlerësimit i "i-Portunus". Detajet lidhur me përpunimin e të dhënave personale disponohen në deklaratën e privatësisë në: [https://ec.europa.eu/info/funding-tenders/rules-public-procurement/data-protection-public-procurement-procedures\\_en](https://ec.europa.eu/info/funding-tenders/rules-public-procurement/data-protection-public-procurement-procedures_en).

## **11. Kontaktet**

Ekipi i "i-Portunus" është në dispozicion për t'iu përgjigjur pyetjeve në lidhje me përmbajtjen e kësaj thirrjeje për aplikime. Të gjitha pyetjet duhet të dërgohen me email në [info@i-portunus.eu](mailto:info@i-portunus.eu).

